



# MARTESAT FIKTIVE NË SHQIPËRI





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

---

*Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë te autor-it/ve dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit*

---



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



# **MARTESAT FIKTIVE NË SHQIPËRI**

**ANALIZË MBI TË DHËNAT E GJENDJES CIVILE DHE  
VENDIMEVE GJYQËSORE**

**2015- 2022**







U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



## Përmbajtja

1. QËLLIMI I RAPORTIT DHE METODOLOGJIA.....	1
2. KORNIZA LIGJORE MBI MARTESËN.....	2
2.1. MARTESA NË TRAJTIMIN LIGJOR.....	2
2.2. PASOJAT E MARTESËS.....	4
2.3. PAVLEFSHMËRIA E MARTESËS .....	5
2.4. MARTESA E SIMULUAR OSE FIKTIVE .....	6
2.4.1. KOSTOT FINANCIARE PËR PROBLEMET LIGJORE QË SHKAKTON NJË MARTESË FIKTIVE PËR OFRUESIT E NDIHMES JURIDIKE SHTETËRORE OSE OJF:.....	13
2.4.2. KONKLUZION I RËNDËSISHËM.....	15
2.5. ROLI I PUNONJËSIT TË GJENDJES CIVILE NË LIDHJEN E MARTESËS.....	15
2.6. ANALIZA E JURISPRUDENCËS SË GJYKATAVE SHQIPTARE PËR MARTESAT FIKTIVE .....	16
3. PASOJAT E MARTESAVE FIKTIVE PËR FËMIJËT E LINDUR GJATË MARTESËS.....	19
4. KONKLUZIONE.....	21
5. REKOMANDIME.....	22
6. BIBLIOGRAFI.....	24
7. ANEKS PLOTËSUES.....	30

## Tabela e grafikëve

Grafiku 1 Numri i martesave fiktive në harkun kohor 2010 - 2021 .....	8
Grafiku 2 Numri i martesave më shumë se një herë (2,3,4,5,6) nga 2010-2021 .....	9
Grafiku 3 Kurba e martesave fiktive mbas vitit 2015 .....	10
Grafiku 4 Martesat fiktive në 2022 sipas 12 qarqeve .....	11
Grafiku 5 Martesat fiktive më shumë se një herë në 2022 .....	11
Grafiku 6 Nr i grave që martohen 1-6 herë, në 2019, para pandemisë .....	11
Grafiku 7 Nr i grave që martohen 1-6 here, në 2021, pas pandemisë .....	11
Grafiku 8 Martesat fiktive, Viti 2019, para pandemisë .....	12
Grafiku 9 Martesat fiktive, Viti 2021, pas pandemisë .....	12
Grafiku 10 Martesat fiktive sipas qarqeve 2010-2021 .....	12
Grafiku 11 Moshë e personave që martohen fiktivisht .....	13
Grafiku 12 Martesat fiktive në 2022 sipas 12 qarqeve .....	16






U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



## 1. QËLLIMI I RAPORTIT DHE METODOLOGJIA

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), me mbështjetjen financiare të granteve të vogla të Ambasadës Amerikane në Shqipëri u angazhua për realizimin e një studimi analitik ligjor dhe social të fenomenit të martesave fiktive<sup>1</sup>, për gjetjet dhe rekomandimet që dalin për ndryshimet e nevojshme ligjore në drejtimit të përmirësimit të mekanizmave ligjorë në mënyrë që strukturat shtetërore dhe sociale të jenë më të kujdesshëm e më të kontrolluar për të minimizuar e shmangur pasojat që vijnë si rezultat i martesave fiktive.

Studimi u mbështet në monitorimet e të dhënave të siguruara nga Shërbimi i Gjendjes Civile, nga Gjykatat e Shkallës së Parë, nga INSTAT dhe në mënyrë të ndjeshme rezulton që trendi i viteve të fundit në Shqipëri shënon rritje të numrit të martesave fiktive. Ajo që bie në sy si një tipar dallues është se në martesat fiktive janë burrat ata që marrin mbiemrin e gruas me qëllimin për të humbur gjurmët dhe shmangur problemet që ju dalin nga expulset, extradimet apo nga rekorde të tjera kriminale, që mund të jenë kryer në Shqipëri apo jashtë saj. Po ashtu del se numri më i madh i grave të përfshira në këto lloj martesash i përket komunitetit Rom dhe Egjiptian, por jo vetëm, nga mazhoranca numri nuk është i papërfillshëm.



Duke analizuar problemin në mënyrë holistike del se këto martesa shoqërohen me pasoja mjaft negative në familje dhe shoqëri, si:

- a) fshehja e individëve të inkriminuar nga drejtësia apo të dëbuar për arsye të ndryshme nga vendet e tjera;
- b) dëmtimi i interesave dhe të drejtave të grave që përfshihen në to;
- c) cënimi i të drejtave të fëmijëve që lindin jo me “bashkëshortët” legjitim, por si rezultat i bashkëjetesave të grave jashtë këtyre martesave;
- d) rritja në mënyrë artificiale e ngarkesës së shërbimit të gjendjes civile dhe e gjykatave për çështjet e lidhjes apo zgjidhjes së martesave, për kundërshtimet dhe njohjet e atësisë, për regjistrimin e lindjeve të fëmijëve, etj;

<sup>1</sup> Me martesë fiktive kuptojmë të gjithë ato martesë të cilat nuk konsumohen as edhe një ditë të vetme në kuptimin që një ligji, që do të thotë se përveçse kryhen veprimet procedurale administrative nga zyrat përkatëse të gjendjes civile në praninë e dy bashkëshortëve dhe me vullnetin e tyre të plotë, kjo lloj martesë shoqërohet me mungesën e bashkëjetesës, të komunikimit ndërmjet bashkëshortëve, të marrëdhënieve intime, të mbështjetjes morale apo materiale, me mungesën e gjërave të përbashkëta, të buxhetit të përbashkët e shumë fakte të tjera të verifikueshme për ekzistencën e institucionit të martesës;





U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



- e) rritja artificiale e shpenzimeve të ekspertizës së kërkuar nga gjykatat si analizat e ADN, apo shpenzime të tjera gjyqësore e noteriale etj;

Qëllimi i Studimit është të adresojë analizën e të dhënave të mbledhura nga burimet e sipërcituara po vecanërisht nga shërbimi i gjendjes civile dhe vendimet gjyqësore për periudhën 2015-2022, dhe të ekspozojë:

- Mënyrën se si janë trajtuar çështjet e martesave fiktive nga gjykatat shqiptare;
- Aspekte të rëndësishme dhe thelbësore të kësaj jurisprudence për trajtimin e martesave fiktive;
- Rolin institucional të Zyrës së Gjendjes Civile, natyrën e vendimeve që merren, diversifikimi i pozicionimit të saj nga një qark në tjetrin në shkallë vendi;
- Identifikimin dhe vlerësimin e nevojës për ndryshime ligjore, për forcimin e filtrave dhe rritjen e kontrollit në këtë drejtim;

Për më tepër hulumtimi i vendimeve gjyqësore për harkun kohor 2015 - 2022 u bazua në kombinimin e analizës së literaturës ligjore dhe të dhënave të mbledhura nga vendimet gjyqësore e të dhënat e Gjendjes Civile, gjë që mundësoi kërkimin e thelluar të përmbajtjes së tyre dhe interpretimin e detajuar të martesës fiktive bashkë me elementët e saj karakteristikë. Vendimet e gjykatave 2015 -2022 dhe të dhënat e siguruara nga shërbimi i Gjendjes Civile për të njëjtën periudhë kohore, të vëna në dispozicion, përbëjnë burimin kryesor të të dhënave për këtë Raport.

## 2. KORNIZA LIGJORE MBI MARTESËN

### 2.1. MARTESA NË TRAJTIMIN LIGJOR

Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën për t'u martuar dhe krijuar familje, duke deklaruar më tej që ato gëzojnë mbrojtje të vecantë nga shteti. Kjo e drejtë, e garantuar nga Kushtetuta, gjen rregullim të mëtejshëm dhe më të detajuar në dispozitat e Kodit të Familjes.

Sipas këtij të fundit, martesë është bashkëjetesa ligjore e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje.

Në doktrinën ligjore bëhet një dallim midis martesës si *akt/veprim juridik* dhe martesës si *raport* apo *marrëdhënie* midis bashkëshortëve. Martesa, në kuptimin e *veprimit juridik*, është shprehja e lirë e vullnetit nga bashkëshortët e ardhshëm, në formën e kërkuar nga ligji, për t'u lidhur në martesë si burrë dhe grua, duke krijuar kështu bashkëjetesën ligjore. Ndërkohë, martesë, në kuptimin e dytë, nënkupton *marrëdhënien juridike* që akti i martesës





U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



krijon midis bashkëshortëve, në formën e të drejtave dhe detyrimeve që lindin për secilin prej tyre. Kështu, martesë është përputhja e vullnetit të të dy palëve që krijon në mënyrë të drejtpërdrejtë mes tyre një marrëdhënie juridike.

Në përmbajtje të dispozitave të Kodit të Familjes mund të vërejmë se ato rregullime ligjore që lidhen me formalitetet që shoqërojnë apo kërkohen të plotësohen deri në momentin e lidhjes së martesës, duke përfshirë edhe këtë të fundit, kanë të bëjnë me aktin e martesës. Ndërsa të gjitha rregullimet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet që lindin pas lidhjes së saj e që vijojnë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së martesës, kanë të bëjnë me martesën si raport apo marrëdhënie.

Martesa, në kuptimin e veprimit juridik, përbën një veprim juridik formal pasi duhet lidhur apo celebruar në formën e kërkuar nga ligji. Para lidhjes së martesës, ligji kërkon kryerjen e publikimit apo shpalljes së saj, në vende të caktuara nga komunitat apo bashkitë, mbi bazën e kërkesës së bashkëshortëve të ardhshëm apo personit të caktuar me prokurë prej tyre që i dorëzohet nëpunësit të gjendjes civile, e shoqëruar me të gjitha dokumentacionin e nevojshëm që provon mungesën e pengesave ligjore për lidhjen e martesës. Martesa nuk mund të celebrohet para kalimit të një afati minimal prej 10 ditësh nga dita e shpalljes dhe në çdo rast, nëse nuk celebrohet brenda një viti nga data e shpalljes, është e domosdoshme të kryhet një shpallje e re. Funkzioni i këtij publikimi është që t'i lejojë rrethit të personave të përcaktuar nga ligji mundësinë e paraqitjes përpara nëpunësit të gjendjes civile të atyre rrethanave apo fakteve për të cilët ata kanë dijeni dhe që përbëjnë pengesë ligjore për lidhjen e martesës.

Pas kalimit të afatit të kërkuar nga ligji për shpalljen, martesë lidhet publikisht përpara nëpunësit të gjendjes civile, në prezencë të bashkëshortëve të ardhshëm dhe të dy dëshmitarëve; nëpunësi i gjendjes civile pasi merr nga secili bashkëshort deklarimin se ata duan të lidhin martesë dhe, pasi merr pelqimin e tyre, i shpall në emër të ligjit të martuar. Menjëherë pas kësaj, hartohet dhe nënshkruhet nga bashkëshortët, dëshmitari dhe nëpunësi i gjendjes civile akti i martesës, i cili regjistrohet në regjistrin e martesave.

Procedura që ndiqet në datën e caktuar për lidhjen e martesës nga nëpunësi i gjendjes civile:

- Identifikon personat që do të lidhin martesën;
- Konstaton plotësimin e kushteve themelore dhe mungesën e pengesave ligjore për lidhjen e martesës.
- Verifikon nëse ka patur kundërshtime për lidhjen e kësaj martesë dhe si janë zgjidhur ato;
- U lexon personave që do të lidhin martesën të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë;
- Merr pelqimin e bashkëshortëve në lidhjen e martesës;
- I shpall në emër të ligjit të martuar;



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



- Harton aktin e martesës, i cili firmoset nga bashkeshortët, dëshmitarët dhe nëpunësi i gjendjes civile;

Pra që martesë të jetë e vlefshme apo të perfeksionohet, ligji kërkon si kusht të domosdoshëm jo vetëm shprehjen e pëlqimit nga secili prej bashkeshortëve të ardhshëm për lidhjen e martesës por edhe deklarin e nëpunësit të gjendjes civile që i shpall ata të martuar.

Përveç kërkesave të formës, ligji kërkon edhe plotësimin e disa kushteve të tjera thelbësore për lidhjen e martesës, të cilat mund të grupohen si vijon:

- (a) moshë madhore (të kenë mbushur 18 vjeç)  
*Vetëm mbi bazën e një vendimi gjykate, për shkaqe të rëndësishme, mund të lejohet martesë nën këtë moshë;*
- (b) pëlqimi i lirë i bashkeshortëve të ardhshëm i shprehur përpara nëpunësit të gjendjes civile
- (c) Status liberum (gjendja e lirë civile e bashkeshortëve të ardhshëm)  
*Nuk mund të lidhë martesë të re ai që rezulton si i martuar në regjistrat e gjendjes civile, nga një martesë e mëparshme;*
- (d) të mos ekzistojnë mes bashkeshortëve të ardhshëm marrëdhënie të farefisnisë, krushqisë, kujdestarisë, adoptimit, sipas përcaktimeve në ligj.
- (e) Shëndeti mendor  
*Nuk mund të lidhë martesë personi që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës.*

## 2.2. PASOJAT E MARTESËS

Siç e përmendëm më sipër, martesë si veprim juridik, pas perfeksionimit të saj, prodhon pasojë në rrafshin personal, social dhe juridik, duke krijuar një sërë të drejtash dhe detyrimesh për bashkeshortët.

Martesa lind detyrimin reciprok të bashkeshortëve për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës. Bashkeshortët kanë gjithashtu detyrën për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e tyre. Për të realizuar përmbushjen e këtij detyrimi prindërve u është njohur pushteti apo përgjegjësi prindërore mbi fëmijët e mitur, përgjegjësi e cila u njihet në mënyrë të barabartë të dy prindërve. Gjithashtu ata duhet të kontribuojnë për nevojat e familjes, në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre.

*Bashkeshortët kanë detyrimin e një jetese të përbashkët e për këtë ata duhet të zgjedhin me marrëveshje një vendbanim.*



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



Martesa krijon bashkëpronësinë mbi të mirat materiale të krijuara nga bashkëshortët, sëbashku ose veç e veç, gjatë martesës, përveç kur ata me marrëveshje kanë zgjedhur një regjim tjetër pasuror, atë të pasurive të ndara. Në këtë kuptim, ligji ka9 parashikuar një sërë detyrimesh mbi mënyrë se si bashkëshortët duhet të administrojnë apo disponojnë mbi pasurinë e përbashkët, në varësi të regjimit pasuror të zgjedhur prej tyre. Megjithatë, ligji sigurohet të bëjë të qartë se zbatimi nga bashkëshortët i të drejtave dhe detyrimeve të tyre që lindin nga martesa ka përparësi për t'u zbatuar, pavararësisht regjimit pasuror të zgjedhur prej tyre.

### 2.3. PAVLEFSHMËRIA E MARTESËS

Në Kreun III të Titullit I, Kodi i Familjes parashikon rastet e pavlefshmërisë së martesës. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave vërehet se këto raste përbëhen nga mosrespektimi i kushteve formale dhe atyre thelbësore për lidhjen e martesës, të cilat i kemi përmendur në seksionet më sipër. Përveç kushteve që janë përmendur tashmë kur kemi trajtuar kërkesat për formalitet të martesës, rrethanave dhe fakteve që përbëjnë pengesë për të lidhur martesë si dhe kushteve thelbësore që kërkohen për lidhjen e martesës, në dispozitat e këtij kreu gjejmë edhe disa situata të reja që çojnë po ashtu në pavlefshmërinë e martesës.

Në përmbajtja e këtyre dispozitave, mund t'i klasifikojmë shkaqet e pavlefshmërisë së martesës, në (a) pavlefshmëri që rrjedh nga mungesa e kushteve thelbësore për lidhjen e martesës ose nga ekzistenca e pengesave ligjore për lidhjen e saj (*mosha e mitur, ekzistenca e martesës së mëparshme, shëndeti mendor, marrëdhëniet e farefisnisë, krushqisë, adoptimit*), (b) pavlefshmëri që rrjedh nga veset e vullnetit (*lajthimi, kanosja, simulimi ose fiktiviteti*), (c) pavlefshmëri që rrjedh nga mosrespektimi i kushteve formale për lidhjen e martesës.

Çka vërehet kur bëhet fjalë për martesën është se në çdo rast bëhet fjalë për pavlefshmëri të saj dhe duket se për këtë institut nuk ka ndonjë dallim mes pavlefshmërisë absolute dhe relative, siç ndodh, për shembull, në rastin e kontratave.

Ajo që bie në sy nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Familjes është se disa raste pavlefshmëria e martesës, e cila megjithëse katë bëjnë me mospërbushjen e kushteve thelbësore që nevojiten për të lidhur një martesë të vlefshme, mund të rregullohet apo të riparohet. Një situatë e tillë vihet re, për shembull, në martesat nën moshën e lejuar apo martesat midis fëmijëve të vëllezërve dhe motrave, për të cilat ligji parashikon se mund të lidhen nëse lejohen nga gjykata, për shkaqe me rëndësi. Gjithashtu, në martesat nën moshën e lejuar nga ligji, pavlefshmëria rregullohet me arritjen e moshës madhore, ose kur nga martesa kanë lindur fëmijë ose gruaja është shtatzënë. Po kështu në raste të tjera pavlefshmëria absolute rregullohet pas kalimit të një afati të caktuar bashkëjetese midis bashkëshortëve (psh. 6 muaj nga shërimi i bashkëshortit të prekur nga sëmundje mendore).



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



Gjykohet që në rastin e martesës, duke konsideruar pasojat/efektet që ajo krijon janë të tilla që shtrihen jo vetëm në aspektin pasuror por edhe në aspekte të tjera me natyrë jopasurore, ligjvënësi ka vlerësuar në këto raste se pasoja që do të vinte nëse martesë nuk do të quhet e vlefshme është më e rëndë se shkakun që e bën atë të pavlefshme.

Në varësi të shkakut të pavlefshmërisë, personat që legjitimohen të ngrenë padi për pavlefshmërinë e martesës e kanë në disa raste bashkëshortët, prokurori por edhe kushdo që ka interes legjitim (psh. martesë fiktive, martesë pa mbushur moshën, martesat brenda gjinisë, krushqisë, kujdestarisë, adoptimit, martesë nga persona që nuk kanë status liberum); në disa raste të tjera legjitimohet vetëm bashkëshorti i prekur nga pavlefshmëria (psh. bashkëshorti vullneti i të cilit nuk ka qenë i lirë, bashkëshorti që ka qenë i kanosur ose në lajthim); në disa raste të tjera kjo e drejtë i takon secilit nga bashkëshortëve (psh. në rastin e martesës të lidhur me një person që vuan nga sëmundje mendore).

Efektet e shpalljes së pavlefshme të martesës me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë prapavepruese; martesë konsiderohet se nuk është lidhur e rrjedhimisht nuk ka prodhuar asnjë pasojë. Nga ky efekt përjashtohen fëmijët e lindur nga këto, që megjithëse në sy të ligjit konsiderohen të mos jenë lidhur ndonjëherë, fëmijët do të konsiderohen si të lindur nga martesë dhe marrëdhëniet e tyre me prindërit rregullohen si në rastet e zgjidhjes së martesës.

Gjithashtu, ligji bën përjashtim edhe për bashkëshortin në mirëbesim, për të cilin pasojat nga deklarimi i pavlefshmërisë së martesës nuk kanë efekt prapaveprues por fillojnë nga data që vendimi merr formë të prerë. Për këtë bashkëshort që është në mirëbesim martesë konsiderohet të ketë prodhuar pasojë njësoj si një martesë e vlefshme deri në datën e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

#### 2.4. MARTESA E SIMULUAR OSE FIKTIVE

Në të ashtuquajturën martesë fiktive, e cila gjen parashikim në nenin 36 të Kodit të Familjes, bashkëshortët e ardhshëm lidhin martesë pa patur qëllim të krijojnë një raport dhe jetë të përbashkët bashkëshortore por vetëm për të përfituar nga disa efekte apo pasoja që derivojnë nga lidhja e martesës. Si kusht i domosdoshëm në këtë rast është ekzistenca e vullnetit të të dy personave që lidhin martesë, vullnet që duhet të ketë ekzistuar përpara lidhjes së saj, për të mos ushtruar të drejtat dhe mos zbatuar detyrimet që rrjedhin nga martesë. Palët pra, janë marrë vesh që të deklarohen fiktivisht si burrë dhe grua por në të vërtetë ata nuk e duan këtë pasojë pasi nuk kanë asnjë qëllim të bashkëjetojnë si burrë dhe grua si edhe të krijojnë atë bashkësi shpirtërore dhe materiale që karakterizon jetën martesore.

Disa nga elementët kryesorë dallues të një martesë të tillë në praktikë janë:

- mungesa e bashkëjetesës;



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



- bashkëjetëse e thjeshtë (pra jo si burrë e grua) për një apo disa periudha të shkurtra;
- mungesa e komunikimit ndërmjet bashkëshortëve;
- mungesa e marrëdhënieve intime, ndihmës apo mbështjetjes morale apo materiale;
- mosrespektimi i detyrimit për besnikëri dhe ekzistenca e lidhjeve të tjera;
- mosnjohja e fakteve të dukshme nga jeta e një bashkëshorti;
- mungesa e gjërave të përbashkëta, një buxhet i përbashkët;
- mosnjohja apo edhe mungesa e lidhjeve me familjarët apo rrethin shoqëror të bashkëshortit;

Kryesisht kjo lloj marrëdhënie krijohet për qëllime të ndryshme përfitimi, të tilla si përfitim dokumentacioni (psh. përfitim leje qëndrimi, nënshtetësie, etj), ndryshim mbiemri me qëllim për t'iu shmangur drejtësisë, përfitime nga trashëgimia, shmangie e detyrimeve fiskale, etj.

Duke qenë se në këtë marrëdhënie mungon vullneti i bashkëshortëve për të krijuar efektet tipike të një martese, ky veprim është i vesuar dhe për rrjedhojë kjo përbën shkak për pavlefshmërinë e kësaj martese, siç është sqaruar edhe në seksionin më sipër që adreson çështjet e pavlefshmërisë së martesës.

Të drejtën e padisë në këtë rast e kanë secili nga bashkëshortët, prokurori dhe kushdo tjetër që ka interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës. Si rregull, ligji parashikon që kjo padi nuk parashkruhet, përveç në rastet e parashikuara në nenet 44 dhe 46 të Kodit të Familjes. Gjykojmë që ligji paraqitet i paqartë në rastet përjashtimore që ai referon si raste që mund të çojnë në parashkrimin e padisë. Nëse i bëjmë referencë parashikimeve në nenin 44, vërejmë se për kanosjen, lajthimin apo martesat pa pëlqim të lirë, padia parashkruhet kur kanë kaluar 6 muaj nga pushimi i kanosjes, zbulimi i lajthimit apo fitimi i lirisë por në çdo rast jo më tepër se 3 vjet nga lidhja e martesës. Gjithashtu padia parashkruhet kur ka pasur një bashkëjetese të vazhdueshme për 6 muaj që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë apo ka marrë dijëni për lajthimin. Ndërkohë në nenin 46 parashikohet se e drejta e padisë parashkruhet me kalimin e afatit 6 mujor nga shërimi i bashkëshortit që vuan nga sëmundje e rëndë psikike ose me zhvillim të metë mendor.

Për shkak të ngjashmërisë dhe afërsisë që legjislacioni ynë civil ka me atë italian, për të hedhur pak më shumë dritë mbi këtë çështje, reference i është bërë dispozitës që parashikon martesën fiktive në legjislacionin italian. Ajo që vërehet është se ligji italian përmban një afat parashkrimi për të drejtën e padisë për këtë rast i cili lidhet me kalimin e një viti nga data e lidhjes së martesës apo nga momenti që personat kanë filluar të bashkëjetojnë si bashkëshortë pas celebrimit të martesës.

Pra, ajo që vihet re është se në një legjislacion të ngjashëm me tonin (legjislacionin italian) për të njëjtën pavlefshmëri ka një afat parashkrimi që lidhet me momentin e lidhjes së martesës ose me fillimin e bashkëjetesës si bashkëshortë midis të celebruarve.




U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



Me sa duket nga dispozita edhe ligjvënësi ynë ka synim që të parashikojë një afat parashkrimi për këtë padi nëse përmbushen disa kushte që ai i konsideron të rëndësishme dhe tregojnë se pavlefshmëria është ndrequr apo riparuar më pas por është e paqartë nga mënyra si është formuluar dispozita se cilat janë këto kushte në rastin e martesës fiktive, cili është afati dhe nga kur fillon të llogaritet ai.


***Si ka shkuar në mënyrë grafike procesi i martesave fiktive në Shqipëri për periudhën e viteve të fundit:***



*Grafiku 1 Numri i martesave fiktive në harkun kohor 2010 - 2021*

Janë marrë në konsideratë të dhënat nga sistemi i gjendjes civile kryesisht për rastet:

- kur bashkëshorti ka marrë mbiemrin e bashkëshortes
- kur e njejta grua regjistron në zyrën e gjendjes civile nga **1, 2, 3, 4, 5 deri në 6** martesë me burra të ndryshëm.
- U përzgjedh periudha 2010-2014 kur nuk kishte ndryshuar ligji dhe duket shumë qartë që fenomeni i martesave fiktive nuk ishte i konsiderueshëm;
- Ndërsa periudha 2015-2021, mbasi ka ndryshuar ligji solli rritjen e numrit të martesave fiktive të cilat arriten kulmin në vitin para pandemisë në 1451 raste dhe mbas pandemisë, pra vitit 2020, filloi përsëri trendi i rritjes sic shihet në 849 raste gjatë 2021.








U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Grafiku 2 Numri i martesave më shumë se një herë (2,3,4,5,6) nga 2010-2021

Për të kuptuar se fenomeni është në rritje u vecuan martesat e të njëjtes grua me më shumë se një burrë, që sipas grafikut më sipër del se janë një numër i konsiderueshëm dhe që është një arsye më shumë për të kuptuar që në një farë mënyrë konsiderohet si “biznes”.

Para se të ndryshonte ligji në vitin 2015, numri i kësaj kategorie martesash sic duket edhe në grafikët më sipër ka qenë i papërfillshëm. Mbas vitit 2015 u ndalua me ligj ndryshimi i mbiemrit nga qytetarët dhe si rezultat, u gjend “martesa fiktive” si “kamerdare shpëtimi” për të interesuarit që donin të realizonin qëllimin e maskimit të mbiemrit. Institucioni i martesës në bazë të ligjit lejon ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit, i cili mund të zgjedhë të marrë atë të bashkëshortes;

***Nga krahasimi i grafikut nr. 1 me grafikun nr.2 del se e njëjta grua është martuar më shumë se një herë në mënyrë të konsiderueshme. Për shembull në vitin 2021 nga 849 gra që kanë pranuar të regjistrojnë martesa për interes në total, 557 prej tyre janë martuar më shumë se njëherë, gjë që çon në konkluzionin se martesa fiktive është parë si mënyrë përfitimi nga secila palë;***






U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Grafiku 3 Kurba e martesave fiktime mbas vitit 2015

Eshtë e rëndësishme të theksojmë duke parë grafiku nr.3 se trendi i martesave fiktime nuk ka rënë, ai filloi të rritet menjëherë përsëri mbas pandemisë. Tabela e mësipërme vërteton këtë fakt.

Po të veçojmë vitin më të fundit 2022, del qartë që qarku i Lezhës në krahasim me qarqet e tjera vazhdon të udhëheq kurbën e numrit më të madh të regjistrimit të martesave për interes. Në qarkun e Lezhës, “tolerancë” për procesin e lidhjes së martesave fiktime e kalon kufirin ose është shfrytëzuar në ekstremin e saj. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar 277 lidhje martesash fiktime.

Nga ana tjetër, pozitivisht bie në sy që zyrat e gjendjes civile në Korçë e kontrollojnë procesin e regjistrimit të martesave fiktime brenda zbatimit të kornizës ligjore, dhe ky qark shënon numrin më të vogël të lidhjes së martesave fiktime, vetëm 17 raste për vitin 2022.


Del si konkluzion se kur punonjësi i gjendjes civile kontrollon me kujdes procedurat në zbatim të ligjit, arrin të influencojë kufizimin rritjen e martesave fiktime.




U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME





Grafiku 4 Martestat fiktive në 2022 sipas 12 qarqeve



Grafiku 5 Martestat fiktive më shumë se një herë në 2022

Edhe nga diagramat e mëposhtme dalin të njëjtat gjetje, ku biznesi i martesave të të njëjtit bashkëshort, që synon të marrë mbiemrin e bashkëshortes është kryesisht në favorin e burrit, dhe jo të gruas, e cila kujton se përfiton ngaqë merr në këmbim një sasi të ardhurash në dorë, të cilat janë shumë më pak nga sa i duhet asaj më vonë të zgjidhi martesën apo probleme të tjera të paparashikuara si derivate i kësaj lidhjeje.

Grafiku 6 Nr i grave që martohen 1-6 herë, në 2019, para pandemisë




Grafiku 7 Nr i grave qe martohen 1-6 here, në 2021, pas pandemisë



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Grafiku 8 Martesat fiktive, Viti 2019, para pandemisë


Komenti që duam të theksojmë është se vërtet ka një ulje të numrit të martesave fiktive për shkak të Covid -19, se njërezit nuk qarkullonin, zyrat pothuaj u mbyllën për një periudhë të caktuar, por menjëherë mbas pandemisë në vitin 2021 filloi kurba përsëri të ngjitet.

Siç theksuam më sipër mbas vitit 2015 rritet numri martesave për interes të të dy palëve dhe veçanërisht e konsiderueshme është rritja para



Grafiku 9 Martesat fiktive, Viti 2021, pas pandemisë

pandemisë së corona virusit. Po të krahasojmë një vit para pandemisë dhe një vit mbas pandemisë, duket qartë që fenomeni vazhdon të ekzistojë në numra të konsiderueshëm. Sigurisht numri i grave që martohen nga dy herë është më i madh, por shohim se janë 113 gra që janë martuar nga tre herë me tre burra të ndryshëm apo edhe 4 herë.



Grafiku 10 Martesat fiktive sipas qarqeve 2010-2021




**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Pyetjes se në cilin qark apo qytet ka qenë më i theksuar fenomeni i regjistrimit të martesave fiktive i përgjigjet tabela nr.8, më sipër, e cila tregon qartazi se në qarqet Elbasan dhe Shkodër numri i tyre është më i madh se 100, në qarqet Berat, Dibër, Durrës dhe Vlorë numri i tyre është më i madh se 200 raste, më i theksuar fenomeni është në qarkun e Fierit, dhe Tiranës ku numri i tyre e kalon 300 dhe kulmin e arrin qarku i Lezhës i cili kalon numrin e 600 rasteve.



Grafiku 11 Mosha e personave që martohen fiktivisht

Në martesat fiktive mbizoterojnë burrat me moshë të re nga 22-42 vjec, të cilët përbëjnë 94% të numrit total dhe vetëm 6% janë mbi moshën 52 vjec.

#### 2.4.1. KOSTOT FINANCIARE PËR PROBLEMET LIGJORE QË SHKAKTON NJË MARTESË FIKTIVE PËR OFRUESIT E NDIHMES JURIDIKE SHTETËRORE OSE OJF:

1. Sa kushton mesatarisht për një bashkëshorte/ nënë të zgjidhë përmes gjykatës çështjen e zgjidhjes së martesës?

Nr	Shpenzimi	Kosto në lekë	Komente
1	Avokati (orë pune)	100,000	Puna e avokatit deri në finalizim
2	Kërkesa dhe njoftimet	3,500	Kërkesë padia



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



3	Psikolog	40,000	Kosto e ekspertizës që kërkon gjykata
4	Transport	30,000	Kostoja mesatare e transportit e palëve
6	Administrative	1,500	Kostoja e shpenzimeve administrative
	<b>Total</b>	<b>175,000 lekë</b>	

2. Sa kushton mesatarisht për një bashkëshorte/ nënë të zgjidhë përmes gjykatës një çështje të Kundërshtimit të Atësisë?

Tabela më poshtë tregon numrin e çështjeve të zgjidhjes së martesave që janë ndjekur nga avokatët e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS në të gjithë vendin:

Lloji i çështjes në gjykatë	Numri në 2020	Numri në 2021	Numri në 2022	Ofruesi
Zgjidhje martesë	53	65	72	TLAS

Nr	Shpenzimi	Kosto në lekë/1 fëmijë	Kosto në lekë/2 fëmijë	Komente
1	Avokati (orë pune)	100,000	100,000	Kostoja mesatare e punës së avokatit deri në mbyllje të procesit
2	Kërkesë Padia	3,300	3,300	Kostoja që paguhet me depozitimin e kërkesë padisë pranë Gjykatave
3	Analiza e ADN	72,000	144,000	Kostoja e ekspertizës që kërkon gjykata për kundërshtimin e atësisë së prezumuar nga martesa fiktive
4	Transport	30,000	30,000	Kostoja mesatare e transportit për avokatin dhe për klientin në Gjykatat e Rretheve
5	Per diem	5,000	5,000	Kostoja mesatare e dietave për avokatin në Gjykatat e Rretheve
6	Administrative	1,000	1,000	Kostoja mesatare e të gjithave shpenzimeve administrative për një çështje gjyqësore
	<b>Total</b>	<b>211,300</b>	<b>283,300</b>	

Në serinë e kostove të përmendura më sipër duhen shtuar orët e punës që ofrojnë gjyqtarët dhe administrata e gjykatës për këto çështje që janë pasojë e martesave fiktive, si edhe orët e punës që ofrojnë punonjësit e gjendjes civile për reflektimin në regjistër të ndryshimeve për vendim gjykatë për këto raste;



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Për të patur një ide të shpenzimeve në shkallë vendi le të shohim tabelën më poshtë e cila tregon numrin e çështjeve të kundërshtimit të atësisë që janë ndjekur nga avokatët e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS në të gjithë vendin, në tre vitet e fundit:

Lloji i çështjes ne gjykate	Numri në 2020	Numri në 2021	Numri në 2022	Ofruesi
Kundërshtim atësie	58	68	42	TLAS

Po t'i shumëzojmë me kostot totale të një rasti në tabelat më sipër, kuptohet që dëmi financiar për këto gra është i papërballueshëm, pa folur këtu për dëmin e madh që ka buxheti i shtetit për një punë që mund të evitohet duke luftuar fenomenin.

Mos të harrojmë që këto dy procese të domosdoshme gjyqësore që duhet të kryejë një bashkëshorte/ nënë për interesin më të lartë të fëmijëve të saj, nuk janë të vetmet ato do të shoqërohen edhe me proceduara të tjera të detyruara për regjistrimin e fëmijëve të cilët do të kalojnë nga fleta familjare e babait të prezumuar tek ai biologjik dhe shpesh ata duhet të regjistrohen nga fillimi sepse i kanë lënë pa identitet derisa të mbyllen proceduarat e gjyqit të kundërshtimit të atësisë.

#### 2.4.2. KONKLuzion I RËNDËSISHËM

Analiza e kostove ka për qëllim të shërbejë një si një shembull i izoluar, i cili duhet të shumëzohet me numrin e martesave fiktive në të gjithë vendin, për të kuptuar shpenzimet totale që mund të evitohen dhe duhet të evitohen se janë në interesin e të gjithëve. Martesat fiktive janë me pasoja jo vetëm sociale e ekonomike për individët në nevojë në këtë rast për gratë në nevojë por edhe me pasoja të ndjeshme për rritjen artificiale të ngarkesës së administratës shtetërore në vecanti të asaj të gjendjes civile, dhe të gjykatave, si edhe për gjyqatret të cilët ngarkohen më një punë që mund të shmanget përmes filtrave dhe mekanizmave të nevojshëm administrative dhe punës ndërgjegjësusee në komunitet;

#### 2.5. ROLI I PUNONJËSIT TË GJENDJES CIVILE NË LIDHJEN E MARTESËS

Punonjësi i Gjendjes Civile përfaqëson interesin publik në procesin e lidhjes së martesës. Meqë martesa nuk është thjesht një marrëdhënie private ndërmjet palëve por ka ndikime më të gjera në shoqëri, legjislacioni përcakton rol aktiv për funksionarët publikë, si përfaqësues të interesit publik në mirëfunksionimin e marrëdhënieve martesore.

Në këtë kontekst, funksioni i punonjësit të Gjendjes Civile në lidhjen e martesës nuk është formal i vlerësimit të shfaqjes së jashtme të vullnetit të bashkëshortëve të ardhshëm por edhe aktiv për të vlerësuar se po lidhet një martesë sipas kushteve ligjore, sipas qëllimeve të përcaktuara në ligj për lidhjen e martesës si edhe në shmangie të pengesave ligjore për lidhjen e martesës.

Sipas nenit 46 “2” të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” ( i ndryshuar):



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



*“Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullësi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet”.*

Është mëse e qartë se Ligji ngarkon punonjësin e Gjendjes Civile me detyrime për të mbrojtur interesin publik për të penguar lidhjen e një martese e cila nuk ndjek qëllimet e ligjit për lidhjen e saj. Numri shumë i madh i martesave fiktive të lidhura në Republikën e Shqipërisë, tregon se mekanizmat pengues për këtë fenomen, i cili bart pasoja qoftë individuale për vetë personat e përfshirë por edhe pasoja sociale më të gjëra nuk kanë funksionuar në mënyrë të përshtatshme.



Grafiku 12 Martesat fiktive në 2022 sipas 12 qarqeve

## 2.6. ANALIZA E JURISPRUDENCËS SË GJYKATAVE SHQIPTARE PËR MARTESAT FIKTIVE

### **Përfundimi i martesës me pavlefshmëri apo zgjidhje të saj:**

Përfundimi i marrëdhënies si bashkëshortë ka njohur praktika të ndryshme të gjykatave.

Ka raste kur vetë bashkëshortet, të cilat kanë pranuar martesën fiktive “për të ndihmuar” bashkëshortin fiktiv të krijojë një identitet të ndryshuar në dokumentat e gjendjes civile nëpërmjet ndryshimit të mbiemrit për shkak të martesës, të mbetur pa mbështetje, kanë përballuar vetë procedurat gjyqësore, shoqëruar natyrshëm edhe me kostot përkatëse. Në këto raste ato nuk hezitojnë t’a deklarojnë edhe vetë fiktivitetin e martesës dhe shkakun e saj, ndryshimin e identitetit dokumentar të “bashkëshortit fiktiv”. Kështu, në vendimin nr. 1126, datë 20.09.2021. gjykata e rrethit gjyqësor Durrës shprehet se “*Paditësja M.K, në gjykim ka deklaruar se thjesht “de jure”, pasi “de facto” ato nuk e kanë konsumuar këtë martesë duke qenë se shkak i lidhjes së kësaj martese nuk ka qenë jetesa e përbashkët por thjesht për dokumenta, për të paditurin A.K. Paditësja ka deklaruar se, në kushtet që kishte dy fëmijë madhorë dhe ish bashkëshorti kishte ndërruar jetë, i padituri i ka kërkuar asaj të lidhin martesë me qëllim që ai ( i padituri) të kishte mundësinë të ndërronte mbiemrin. Gjykata vlerëson se kjo padi duhet pranuar pasi krijon bindjen se martesa nuk është konsumuar ndërmjet palëve duke u mbështetur në diferencën shumë të madhe të moshës si dhe faktit të mungesës së konsumimit të bashkëjetesës”*





U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Ndërsa nëvendimin nr. 235, datë 12.09.2022. gjykata e rrethit gjyqësor Mat, shprehet;

*“Paditësi M.B (Gj), në kërkesë padi dhe gjatë gjykimit, palët deklaruan se shkak i lidhjes së kësaj martesë ishte ndryshimi i mbiemrit të paditësit M., nga “Gj...” në “B...” për shkak të problemit që ai ka patur me pasaportën me mbiemrin “Gj...” nuk mund të lëvizte jashtë shtetit pasi kishte ndalim për shkak të thyerjes së rregullit të lëvizjes në shtetet anëtare të B. E”.*

Në një rast tjetër, fiktiviteti është përdorur si shkak për të përfituar qëndrim të ligjshëm në një shtet të Bashkimit Europian ( Itali) nëpërmjet bashkimit familjar fiktiv. Kështu në vendimin e saj, nr. 1612, datë 28.10.2019, gjykata e rrethit gjyqësor Durrës, shprehet, *“Paditësja M. H është në moshën 49 vjeç dhe ka dashur që të shkojë në Itali si emigrante dhe, meqë nuk mund të qëndronte më shumë se tre muaj, ajo ka lidhur martesë me të paditurin G. H i cili ishte rezident aty, me qëllim të përfitonte qëndrimin në Itali nëpërmjet bashkimit familjar. Të dy palët deklaruan se lidhja e martesës nuk është bërë me qëllimin për krijimin e jetesës së përbashkët por, me qëllimin e përfitimit të qëndrimit në Itali të paditëses”*

Janë konstatuar edhe raste të fiktivitetit për shkak të mungesës së vullnetit të lirë të njërit prej bashkëshortëve.

Në Vendimin nr. 729, datë 14.07.2020, gjykata e rrethit gjyqësor Durrës, shprehet se;

*“Në rastin objekt shqyrtimi jemi para rastit tipik të parashikuar nga neni 33 i Kodit të Familjes, pasi për martesën e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqës kanë dhënë pëlqimin prindërit e paditëses R. U dhe jo vetë paditësja. Kjo e fundit ka pranuar të lidhë këtë martesë duke u ndjerë e detyruar nga familja e saj, për hir të respektit, vlerësimi dhe mentalitetit që rrethi i saj familjar ka”.*

Në shumë raste, konstatohet se palët i janë drejtuar gjykatës me kërkesë për zgjidhjen e martesës edhe pse nga rrethanat është e qartë se martesë ka qenë fiktive. Nisur nga deklaratimet e palëve dhe faktet e marra në shqyrtim, gjykatat kanë krijuar bindjen se në fakt palët nuk kanë pasur qëllim të krijojnë një jetesë të përbashkët si burrë e grua dhe se martesë është lidhur me qëllimin e vetëm që bashkëshorti të merrte mbiemrin e gruas. Në këto kushte, gjykatat kanë vlerësuar se ndodheshin përpara pavlefshmërisë së martesës dhe se padia e ngritur nga palët për zgjidhjen e martesës ishte e pabazuar në ligj e si e tillë duhej rrëzuar. Për këtë arsye, në përfundim gjykatat kanë vendosur të rrëzojnë kërkesën e palëve për zgjidhjen e martesës dhe të konstatojnë pavlefshmërinë e saj.

Vlerësohet se gjykatat në këto raste kanë mbajtur qëndrime të drejta në kushtet kur *“veprimi juridik që është i pavlefshëm mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër vullnetit (dëshirës) të saj”<sup>2</sup>.*

<sup>2</sup> Vendim Unifikues Civil Nr.5, datë 30.10.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



Për më tepër ky qëndrim i gjykatave është qëndrim që duhet të vlerësohet në pajtim me vetë qëllimet e Kodit të Familjes në dispozitat përkatëse ligjore me të cilat rregullon “zgjidhjen e martesës” dhe dallimin e saj nga “pavlefshmëria e martesës”. Një martesë që nuk ka ekzistuar nuk mund të konsiderohet e zgjidhur por, e paqenë.

*Në rastin konkret, Gjykata ndodhet para një sërë faktesh, të cilat i krijojnë bindjen se martesa e lidhur ndërmjet paditësit M. T (B) dhe të paditurës R. T është e pavlefshme, për shkak se është lidhur pa patur si qëllim jetesën e përbashkët. Rezulton se paditësi dhe e paditura, të pyetur veças për njohjen mes tyre kanë dhënë të dhëna të ndryshme. Rezulton gjithashtu se paditësi ka një diferencë të konsiderueshme moshe me të paditurën, rreth 29 vjet. Rezulton gjithashtu se paditësi ka ndërruar mbiemrin për shkak të martesës duke marrë mbiemrin e bashkëshortes. Vetëm pak kohë pas lidhjes së martesës palët i janë drejtuar gjykatës me padi për zgjidhjen e martesës. Nisur nga sa më sipër, dhe sidomos nga deklaratimet kontradiktore të palëve, gjykata krijon bindjen se martesa nuk është lidhur me qëllimin e të dy palëve për të jetuar si burrë e grua, por për të krijuar mundësinë paditësit që të ndryshojë mbiemrin për shkak të martesës. Në përfundim gjykata ka vendosur “rrëzimin e padisë për zgjidhjen e martesës, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të martesës” (vendimi nr. 301 datë 13.02.2021 gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë).*

Por, ajo që vihet re në mënyrë dominuese nga vendimet e studiuara është fakti që gjykatat mbajnë qëndrim formal duke pranuar kërkesat formale të palëve me objekt “zgjidhjen e martesës” edhe pse rrethanat e trajtuara në vendimin gjyqësor tregojnë qartazi faktin se martesa ka qenë e lidhur në mënyrë fiktive. Kështu, nga rrethanat e referuara në përmbajtjen e vendimeve gjyqësore është konstatuar se të gjitha rastet paraqesin të njëjtat rrethana:


- (i) Pas martesës bashkëshorti ka marrë mbiemrin e bashkëshortes;
- (ii) Koha nga lidhja e martesës e deri ne depozitimin e padisë për zgjidhjen e martesës është shumë e shkurtër dhe varion 1-2 muaj deri maksimalisht pak më shumë se një vit;
- (iii) Nga martesa nuk ka fëmijë dhe as priten fëmijë; thuajse në të gjitha rastet bashkëshortet (gratë) kanë fëmijë nga martesa të mëparshme;
- (iv) Në të gjitha rastet ka veçim të bashkëshortëve shumë pak kohë pas lidhjes së martesës (në shumë raste për shkak se burrat janë larguar jashtë Shqipërisë);



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



### 3. PASOJAT E MARTESAVE FIKTIVE PËR FËMIJËT E LINDUR GJATË MARTESËS



Në disa raste të marra në shqyrtim, palët i janë drejtuar gjykatës me padi për kundërshtimin e atësisë së prezumuar të fëmijës. Rezulton së në gjykim janë përfshirë në cilësinë e personit të tretë personat që pretendohen të jenë babai biologjik i fëmijës, të cilët, sipas përmbajtjes së vendimit, rezulton të kenë pranuar se janë babai i fëmijës dhe kanë deklaruar se e njohin atë si fëmijën e tyre.

Siç kuptohet nga përmbajta e vendimeve, martesat e paditëseve me babain e prezumuar të fëmijës janë zgjidhur më parë me vendim gjykate dhe fëmijët kanë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës. Më tej, po sipas përshkrimeve që gjenden në këto vendime, megjithëse gjykatat kanë disponuar për “zgjidhjen e martesës”, dyshimet janë që në fakt kemi pasur të bëjmë me pavlefshmëri martese (në të gjitha rastet burrat kishin marrë mbiemrin e gruas pa treguar një arsye përse e kishin kryer këtë veprim).

Në përfundim, gjykatat kanë disponuar për pranimin e padisë, duke urdhëruar ZGJC të ndryshojë gjeneralitetin e fëmijës në rubrikën e atësisë, duke hequr emrin e “babait të prezumuar” dhe duke vendosur shënimin “i panjohur”.

Në raste të tjera, palët i janë drejtuar gjykatës me padi për kundërshtimin e atësisë së prezumuar të fëmijës dhe njohjen e atësisë së atit biologjik të tij. Rezulton që në gjykim janë përfshirë në cilësinë e personit të tretë personat që pretendohen të jenë babai biologjik i fëmijës.

Ashtu siç është evidentuar edhe më sipër, edhe në këto raste, nga përmbajta e vendimeve rezulton se martesat e paditëseve me babain e prezumuar të fëmijës janë zgjidhur më parë me vendim gjykate dhe fëmijët kanë lindur ose gjatë kohëzgjatjes së martesës ose brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës. Më tej, po sipas përshkrimeve që gjenden në këto vendime, megjithëse gjykatat kanë disponuar për “zgjidhjen e martesës”, dyshimet janë që



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



në fakt kemi pasur të bëjmë me pavlefshmëri martese (në thuajse 99% të rasteve, burrat kishin marrë mbiemrin e gruas).

Në një rast, gjykata në përfundim të gjykimit ka disponuar për pranimin pjesërisht të padisë, duke pranuar kundërshtimin e atësisë, ndërkohë që për njohjen e saj e ka rrëzuar kërkesën (për sa kohë që palët nuk kanë pranuar ti nënshtrohen analizës gjenetike) dhe i ka orientuar ata të procedojnë me njohjen vullentare të atësisë konform nenit 181 të Kodit të Familjes.

Në një rast tjetër, gjykata ka pranuar padinë sa i takon pjesës së kundërshtimit të atësisë së prezumuar por ndërkohë nuk është shprehur në dispozitiv lidhur me kërkesën për njohjen e atësisë. Siç rezulton nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit, gjykata ka urdhëruar kryerjen e testit gjenetik për të provuar lidhjen gjenetike midis fëmijës dhe personit që pretendon të jetë babai biologjik i fëmijës (i cili në gjykim ka pranuar që ishte babai i fëmijë dhe e njihte atë si fëmijën e tij).

Në rastet e tjera, gjykata në përfundim të gjykimit ka disponuar duke pranuar kundërshtimin e atësisë si edhe duke njohur atësinë e babait biologjik. Në të gjitha këto raste, janë administruar në cilësinë e provës testet gjenetike si për babain e prezumuar të fëmijës ashtu edhe për personin që pretendohet të jetë babai biologjik i fëmijës.

Në rastet e përshkruara më sipër, në të cilat ka kërkim edhe për njohjen e atësisë së fëmijës, konstatohet se personat që pretendojnë të jenë babai biologjik i fëmijës, kanë qenë palë në gjykim dhe kanë pranuar përpara gjykatës atësinë e fëmijës dhe se e njohin atë si fëmijën e tyre. Referuar dispozitave të Kodit të Familjes, vlerësojmë se njohja e fëmijës (të lindur jashtë martese) është një deklaram i lirë i prindit, që mund të bëhet përpara nëpunësit të gjendjes civile, përpara gjykatës ose me testament. Sipas nenit 181 të Kodit të Familjes, atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njuh fëmijën si të tij dhe kjo njohje e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e lajmëron nëpunësi i gjendjes civile. Siç mund të konstatohet nga përmbajtja e këtyre dispozitave, ligji nuk kërkon prova të mëtejshme përveç deklaramit të atësisë. Për analogji me këtë parashikim, gjykojmë se i njëjti standart duhet të aplikohet edhe kur deklarami i njohjes së fëmijës bëhet përpara gjykatës; kërkimi i provave të mëtejshme të tilla si testet gjenetike apo orientimi i palëve që për njohjen e atësisë të ndjekin deklaramin vullnetar përpara ZGJC, të parashikuar në nenin 181 të Kodit të Familjes, nuk janë të nevojshme dhe vetëm sa kontribuojnë në zgjatjen e procedurave. Për më tepër rëndimi i kostove të procesit me kërkesa të tilla provuese çënon edhe interes e ligjshme të fëmijës, i cili do të mbetet përkohësisht me babain e paregjistruar si të tillë ndonëse deklaramet e të dy prindërve janë bërë rregullisht para gjykatës.

Ky qëndrim nuk duket se pajtohet me frymën e ligjit që rregullon marrëdhëniet prind- fëmijë dhe nuk merr në konsideratë “interesin më të lartë të fëmijës” si një parim shumë i rëndësishëm në procedurat gjyqësore në të cilat përfshihen fëmijët.



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



#### 4. KONKLUZIONE

- Martesat fiktive duhen konsideruar fenomen negativ për interesat publike si në pikëpamje sociale ashtu edhe ekonomike;
- Fenomeni i martesave fiktive ka njohur rritje të numrit sidomos për ta përdorur atë si një mekanizëm të ndryshimit të të dhënave të identitetit në regjistrimin e gjendjes civile;
- Pasojat e një martese fiktive lidhen me rritjen e ndjeshme të zgjidhjeve të martesave ( numrit të divorceve) duke ndikuar në ndjeshmërinë publike për rëndësinë e martesës si një marrëdhënie e rëndësishme për forcimin e ndjenjës së familjes dhe rolit të saj në shoqëri;
- Pasoja të tjera negative nga lidhja e martesave fiktive vlerësohen edhe, mundësia e fshehjes apo shmangies së individëve të inkriminuar nga drejtësia, dëmtimi i interesave dhe të drejtave të grave që përfshihen në to, interesave të fëmijëve që lindin gjatë kohëzgjatjes së këtyre martesave, rritja në mënyrë artificiale e ngarkesës së gjykatave në drejtim të zgjidhjes së çështjeve të tilla si divorci, njohja e atësisë, regjistrimi i lindjes së fëmijës, etj.







U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



## 5. REKOMANDIME

***Për shkak të ndikimit negativ në shoqërinë tonë të lidhjes së martesave fiktive duhet të konsiderohen masa ligjore dhe institucionale që kufizojnë këtë fenomen;***

Psh pyetje dhe evidentimi i elementëve kryesorë dallues të një martese të tillë në praktikë për të kuptuar apo kontrolluar mungesën e bashkëjetesës, të komunikimit ndërmjet bashkëshortëve, të marrëdhënieve intime, të ndihmës apo mbështjetjes morale apo materiale, mosnjohjen e fakteve të dukshme nga jeta e një bashkëshorti, mungesa e gjërave të përbashkëta, mosnjohja e lidhjeve me familjarët e secilit, etj;

***Është domosdoshmëri rritja e edukimit ligjor të shtetasve, kryesisht të gjinisë femërore, për të njohur më në detaje pasojat negative që passjell për to lidhja e një martese fiktive;*** Joshja fillestare kundrejt një përfitimi modest material është e pakrahasueshme me dëmet materiale dhe sociale që pasojnë. Të bëhet e qartë që nisma për martesë fiktive propozohet në të gjitha rastet ( 99 %) nga burri ose “bashkëshorti” i ardhshëm, është ai që ofron dhe pagesën në këmbim të aktit ligjor të lidhjes së martesës. Këtu mbaron çfardo lloj detyrimi tjetër nga ana e tij. Por pikërisht këtu fillojnë detyrimet që nëse do të vazhdojë jetën normale do i duhet t’i zgjidh e vetme gruaja, ose “bashkëshortja”. Është ajo që duhet të fillojë procedurën e zgjidhjes së martesës, të sigurojë shërbimin e avokatit, në rastin me fëmijë ( me bashkëjetues) edhe shërbimin e psikologut, fëmija i lindur jasht kësaj martese do duhet të regjistrohet me baba të prezumuar, që do të thotë se duhet të bëhet kundërshtimi i atësisë që kërkon nanalizë ADN, e shpenzime të tjera gjyqësore dhe noteriale, etj. *Një grua në kushte vulnerabiliteti nuk mund të ndjekë dhe përballojë këto veprime as financiarisht as edhe administrativisht pa asistencën e profesionistëve.*

***Organet përkatëse duhet të marrin masa që e bëjnë të padobishme ndryshimin e mbiemrit në evidentimin publik të rekordeve personale të shtetasve nëpërmjet vlerësimit më të plotë të elementëve të tjerë identifikues ( numri personal i identifikimit);***

***Kërkohet të vendoset një bashkëpunim më i mirë ndërmjet shërbimit të gjendjes civile dhe organeve të rendit për të shkëmbyer informacionet që lidhen me ndryshimet e identitetit nëpërmjet martesës, si një mekanizëm dekurajues për të lidhur martesë fiktive me qëllim ndryshimin e të dhënave të identitetit;***

Të rritet ndërgjegjësimi, nëpërmjet aktiviteteve të trainimit, për punonjësit e gjendjes civile, lidhur me rolin e tyre jo formal në lidhjen e martesës.

Të pajisen punonjësit e gjendjes civile me akte udhëzuese për veprimet dhe kompetencat e tyre në procedurën e lidhjes së martesës.



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



Të rritet bashkëpunimi me aktorë të tjerë ndikues në reduktimin e martesave fiktive si, NJMF- të, shërbimi social, të organizatave me bazë komunitare etj, nëpërmjet rolit të tyre ndërgjegjësues.

***Duhet të bashkëpunohet me institucionet e edukimit të gjyqtarëve për trajnimin e tyre lidhur me rolin e tyre jopasiv në rastet e evidentimit të një martese fiktive në rastet kur kërkohet zgjidhja e saj.*** Mungesa e evidentimit të martesës fiktive duke e zgjidhur atë në vend të deklaramit të pavlefshmërisë së saj çënon ndërgjegjësimin e shtetasve për rëndësinë e martesës si një institucion që gëzon mbrojtje kushtetuese;

Të vlerësohet mundësia e ndryshimeve në Kodin e Familjes lidhur me mundësinë e ndryshimit të mbiemrit, si dhe procedura të lehtësuara të zëvendësimit me atin e prezumuar me atin që njih vullnetarisht fëmijën si të tijin;



---

*Studimi mbi martesat fictive në Shqipëri dhe problemet që shkaktojnë ato për familjet përkatëse, gratë, fëmijët e tyre, për ndikimin që kanë në rritjen artificiale te numrit të personave në rrezik pashtetësie, u realizua nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, DPGJC, dhe me mbështetjen financiare te Ambasadës Amerikane në Tiranë.*

---





U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



## 6. BIBLIOGRAFI

- ✓ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ Kodi i Familjes;
- ✓ Ligji Nr. 10129, datë 11.05.2009 “ Për Gjendjen Civile” ( i ndryshuar);
- ✓ 150 Vendime gjyqësore

<b>Inicialet</b>	<b>Nr. 1 Vendimit dhe data</b>	<b>Objekti</b>	<b>Gjykata e Rrethit</b>
M.B	62-2019-4573 (1184); Data 17.09.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
E.H	230 ; Data 05.11.2019	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kukes
F.GJ	152 Data 11.03.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lac
K.C	62-2019-880 (183) ; Data 18.02.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
L.D	730-214 Data 06.06.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lac
I.GJ	900-196 Data 11.07.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lac
I.GJ	315-93 Data 18.03.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lac
XH.C	13-2019-430 ; Data 22.01.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Elbasan
Z.T	62-2019-5978 (1631) ; Data 22.11.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
A.Q	62-2019-6399 (91772) ; Data 13.12.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
A.M	62-2019-3634 (977) ; Data 03.07.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
A.T	41-2019-3508 (1144) ; Data 10.10.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korce
M.LL	41-2019-3617 (1182) ; Data 17.10.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korce
E.SH	41-2019-3291 (1075) ; Data 25.09.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korce
R.H	11-2020-598-166 Data 31.01.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës
K.SH	62-2019-4349 (1148) ; Data 06.09.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
M.F	62-2019-3245 (832) ; Data 13.06.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
A.B	711-140 Data 30.05.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lac
A.Z	62-2019-6674 (1860) ; Data 27.12.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
XH.C	78 ; Data ; 22.01.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Elbasan
D.R	62-2019-5528 (1469) ; Data 31.10.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier
H.GJ	299-88 Data 13.03.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lac



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



M.S	62-2019-898 ; Data 18.02.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.K	596 ; Data 13.06.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat
M.XH	62-2019-717 ; Data 11.02.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
E.C	62-2019-6027 ; Data 25.11.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.Z	62-2019-1677 (378) ; Data 28.03.2019	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.H	62-2020-2311 (561) ; Data 09.07.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
M.XH	62-2020-1088 ; Data 09.03.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
S.S.	62-2020-3766 (930) ; Data 13.10.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
H.M	269 ; Data 29.10.2020	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Kruje
R.L	62-2020-3651 ; Data 08.10.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.I	1367-335 Data 14.12.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
XH.L	41-2020-3327 (1048) ; Data 19.11.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Korce
A.T	62-2020-2529 ; Data 21.07.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
F.GJ	359-110 ; Data 06.05.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
R.I	62-2020-1764 ; Data 10.06.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.H	62-2020-387 ; Data 29.01.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.G	2116 ; Data 18.06.2020	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane
V.B	10(54) ; Data 16.01.2020	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lushnje
K.P	111 ; Date 24.06.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor Diber
XH.D	141 ; Data 13.07.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Diber
R.H	1635 Data 14.12.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Durres
A.N	1229-294 Data 10.06.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
M.F	586(62-2020-2362) ; Data 14.07.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.Y	62-2020-1118(325) ; Data 09.03.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
G.S	62-2020-1116(326) ; Data 09.03.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
S.B	4349 ; Data 15.10.2020	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



K.H	540(1822) ; Data 01.10.2020	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lushnje
R.S	1058-192 Data 21.10.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
XH.L	41-2020-3327 (1048) ; Data 19.11.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Korce
T.N	41-2020-2362 (734) ; Data 17.09.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Korce
E.M	1269-238 Data 27.11.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
R.P	316-111 ; Data 06.05.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
K.N	80- 23, Data 24.01.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
XH.L	41-2020-3327(1048) ; Data 19.11.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Korce
O.M	62-2020-2078 (496); Data 26.06.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
M.A	62-2020-3290 (842) ; Data 24.09.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
S.L	1867 ; Data 08.09.2020	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Vlore
A.B	1444-364 ; Data 24.12.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
I.S	62-2020-2941 (746) ; Data 10.09.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.I	1367-335 ; Data 14.12.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
E.S	62-2020-4601(1186) ; Data 23.11.2020	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
XH.D	790-278 ; Data 11.06.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
A.Q	62-2021-3773 (843) ; Data 21.07.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
DH.K	561 ; Data 01.06.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat
D.Z	41-2021-1144(347) ; Data 30.03.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Korce
B.G	62-2021-4715 (953) ; Data 07.10.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.N	1604-526 Data 21.12.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
B.H	62-2021-4828 (975) ; Data 13.10.2021	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
R.S	62-2021-3715 (841) ; Data 19.07.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
L.D	783-272 Data 10.06.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
S.C	62-2021-6269(1259) ; Data 20.12.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
L.H	729 ; Data 30.07.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



F.V	5884 ; Data 16.09.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane
R.S	1245-266 Data 11.10.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
A.I	782-271 Data 10.06.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
A.T	41-2021-1699(495) ; Data 11.05.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Korce
H.C	62-2021-1559 (441) ; Data 18.03.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
I.N	62-2021-3614 (827) ; Data 12.07.2021	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
D.V	62-2021-814 ; Data 11.02.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.K	1161-244 Data 21.09.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
A.D	639 ; Data 29.06.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat
SH.F	884 ; Data 04.11.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat
S.B	62-2021-2280 ; Data 26.04.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
L.K	62-2021-1547 ; Data 18.03.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.I	782-271 ; Data 10.06.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
L.M	62-2021-2389 ; Data 04.05.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
B.M	62-2021-5261 ; Data 02.11.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
N.C	704 ; Data 21.07.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat
R.P	1047-352 ; Data 27.07.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
A.L	314-103 ; Data 05.03.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
H.GJ	496-172 Data 15.04.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
V.F	1180(62-2021-5859) ; Data 01.12.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
V.N	780-278 ; Data 09.06.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kurbin
A.C	62-2021-2602 ; Data 18.05.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
M.T	301 ; Date 13.12.2021	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kruje
H.D	63; Data 01.02.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat
B.D	62-2021-264(95) ; Data 22.01.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.D	639 ; Data 29.06.2021	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Berat



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



T.T	467-161 ; Data 09.04.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Lac
R.J	11-2021-6412 (1264) ; Data 13.10.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Durrës
L.M	62-2021-1035 (295) ; Data 19.02.2021	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
D.M	62-2021-6051(1216) ; Data 09.12.2021	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
D.Z	62-2022-1841(445) ; Data 12.05.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.SH	62-2022-3530 (703) ; Data 28.09.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
Q.A	62-2022-961 (198) ; Data 01.03.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
F.S	62-2022-4888 (996) ; Data 16.12.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
E.S	62-2022-3745 (746) ; Data 10.10.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
E.B	256(62-2022-1215) ; Data 17.03.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
DH.S	257(62-2022-1213) ; Data 17.03.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.SH	62-2022-4221 (839) ; Data 31.10.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.M	62.2022-3581 ; Data 03.10.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.N	62.2022-848 ; Data 24.02.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.C	62-2022-1568 ; Data 26.04.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
M.F	62-2022-2096 (493) ; Data 30.05.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
E.M	62-2022-3797(769) ; Data 12.10.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
I.D	62-2022-1837 (443) ; Data 12.05.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.Z	62-2022-415(72) ; Data 01.02.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
N.F	115(62-2022-5901) ; Data 10.02.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
K.C	254(62-2022-1189) ; Data 15.03.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
D.H	62-2022-4218(836) ; Data 31.10.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
N.H	62-2022-4459 (902) ; Data 16.11.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
A.B	62-2022-3605(722) ; Data 04.10.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
E.B	62-2022-35 ; Data 17.01.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier
M.B	235 ; Date 12.09.2022	Pavlefshmeri martese	Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Mat



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



O.XH	6156 ; Date 22.11.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Tirane
B.B	567 ; Date 22.11.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
T.L	222 ; Date 27.04.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lezhe
A.S	41-2022-606(158) ; Date 28.02.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Korce
E.Q	302 ; Date 15.06.2022	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
F.XH	144 ; Date 13.01.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
F.H	63-2023-144 ; Date 26.01.2023	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
E.F	652 ; Date 09.12.2022	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
I.M	410 ; Date 22.09.2022	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
DH.Y	600 ; Date 30.11.2022	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
P.B	4436 ; Date 09.09.2022	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Tirane
B.B	431 ; Data 29.09.2022	Kundershtim atesie i prezumuar	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
H.L	291 ; Data 08.06.2022	Vertetim atesie	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Berat
H.GJ	71-30 Data 19.01.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac
S.M	430-153 Data 06.04.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac
K.K	439-157 Data 08.04.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac
I.GJ	1096-408 Data 17.10.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac
F.GJ	737-274 Data 20.06.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac
L.D	167-59 Data 10.02.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac
A.L	781-288 Data 29.06.2022	Zgjidhje Martese	Gjykata e Rethit Gjyqesor, Lac



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME




## 7. ANEKS PLOTËSUES

**Grafikët përsa i përket Martesave gjatë Viteve 2010 -2021 krahasuar me grupmoshën e cila është e aftë për punë**

### Viti 2010



### Viti 2011








**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



### Viti 2012



### Viti 2013





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BRENDSHME




**Viti 2014**

**Grafiku për rastet me 2 martesa**



**Grafiku për rastet me 3 martesa**






U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




## Viti 2015

### Grafiku për rastet me 2 martesë



### Grafiku për rastet me 3 martesë





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME




## Viti 2016

### Grafiku për rastet me 2 martesa



### Grafiku për rastet me 3 martesa





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME




**Viti 2017**

**Grafiku për rastet me 2 martesa**



**Grafiku për rastet me 3 martesa**





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME




## Viti 2018

### Grafiku për rastet me 2 martesa



### Grafiku për rastet me 3 martesa





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME




**Viti 2019**

**Grafiku për rastet me 2 martesa**



**Grafiku për rastet me 3 martesa**








U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




## Viti 2020

### Grafiku për rastet me 2 martesë



### Grafiku për rastet me 3 martesë





U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME



## Viti 2021

### Grafiku për rastet me 2 martesa:



### Grafiku për rastet me 3 martesa

